



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVO - REPUBLIC OF KOSOVO
AGJENCIA KOSOVARE E PRIVATIZIMIT - KOSOVSKA AGENCIJA ZA PRIVATIZACIJU - PRIVATISATION AGENCY OF KOSOVO

Rr. Ilir Konushevci Nr.8 ♦ Prishtinë ♦ Kosovë Tel: ++381 38 500 400 0 Fax: ++ 381 38 248 076 E-mail: info@pak-ks.org
www.pak-ks.org

LISTA PËRFUNDIMTARE E PUNËTORËVE TË CILËT I KANË PLOTËSUAR KUSHTET PËR MARRJEN E NJË PJESE TË TË HYRAVE, SIPAS NENIT 10 TË RREGULLORES SË UNMIK-ut 2003/13 (ME NDRYSHIME)

NSH. "SEK-KOS/SIRKOS" (PRN050) në Prishtinë Fi 806/89

Sipas nenit 10 të Rregullores së UNMIK-ut 2003/13 (me ndryshime), 20% e të hyrave nga shitjet prej privatizimit dhe likuidimit të NSH-së së lartpërmendur do t'u shpërndahet punëtorëve të NSH-së të cilët i plotësojnë kushtet e parapara.

Në vijim është dhënë lista e personave të cilët i kanë plotësuar kushtet për marrjen e një pjese të 20 % prej të hyrave nga shitja dhe përvoja e tyre e punës:

Mbiemri	Emri	Vite pune	Mbiemri	Emri	Vite pune	Mbiemri	Emri	Vite pune
Berisha	Hatixhe	30,30	Gubetini	Nuhi	23,49	Krasniqi	Ujup	28,38
Bunjaku	Perihane	17,93	Haxhijakupi	Sami	22,33	Miftari	Vehbi	29,81
Fejzullahu	Skender	23,22	Jakupi	Shukrije	29,55	Salihu	Salih	23,36
Gashi	Fatmir	22,88	Kosumi	Nazif	24,09	Shabani	Fitnet	28,59
Gashi	Mihrije	25,42	Krasniqi	Fahrije	30,30	Tmava	Musli	21,66

Sipas nenit 10.4 të Rregullores së UNMIK-ut 2003/13 (me ndryshime), punëtori ka të drejtë të marrë një pjesë të 20 % të të hyrave nga shitja nëse ai/ajo ka qenë i evidentuar si punëtor i NSH-së së lartpërmendur në kohën e privatizimit ose likuidimit (cilado që ka ndodhë më parë) dhe që ka qenë në listën e pagave të NSH-së të paktën për tri vite. Punëtori i cili nuk e plotëson këtë kriter megjithatë mund të ketë të drejtë nëse diskualifikimi i tij/saj është bërë në bazë diskriminuese.

Secili person i cili mendon se ai/ajo do të duhet të jetë përfshirë në listë, që dëshiron ta kundërshtoj një ose më shumë emra në listë, ata të cilët mendojnë se stazhi i tyre i punës nuk është i saktë ose dëshirojnë të bëjnë anekse lidhur me mënyrën e shpërndarjes së fondeve sipas nenit 10.5 të Rregullores së UNMIK-ut 2003/13 (me ndryshime), atëherë secili prej tyre mund të parashtrorjë anekse në Odën e Veçantë të Gjykatës Supreme të Kosovës në pajtim me nenin 64.6 të Urdhërësës Administrative Nr. 2006/17 në lidhje me Rregullat e Procedurës së Odës së Veçantë. Aneka duhet të behet me shkrim dhe duhet të përmbaj (1) emrin (emrat) e individit (individëve) në emër të të cilit është parashtruar aneksa (parashtruesi (parashtruesit e aneksave); (2) adresën e parashtruesit (parashtruesve) të anekses dhe (3) arsyet e detajuara faktike dhe ligjore për parashtrimin e anekses me dëshmi plotësuese (në rastet kur janë të aplikueshme), kurse kopjet e dokumenteve duhet të jenë të vërtetuara nga organi kompetent. Kur aneksa është parashtruar në emër të parashtruesit (parashtruesve) të anekses nga pala e tretë (p.sh avokati), pala e tretë duhet ta siguroj autorizim me shkrim me të cilin vërtetohet se është i autorizuar për të vepruar në emër të parashtruesit (parashtruesve) të anekses.

Ankesat duhet të parashtrohen në Odën e Veçantë në këtë adresë:

Oda e Veçantë e Gjykatës Supreme të Kosovës

Rr. Nazim Gafurri nr. 31

10000 Prishtinë,

KOSOVE

TË GJITHA ANKESAT NË LIDHJE ME KËTË NJOFTIM DUHET TË DORËZOHEN DERI MË DATËN 27 NËNTOR 2010 PARA PËRFUNDIMIT TE ORARIT TË PUNËS SË TË NJEJTËS DITË

Për informata shtesë lidhur me atë se si duhet të parashtrorhet aneksa, ju rekomandojmë që ju apo avokati juaj të shikoj nenin 10 të Rregullores së UNMIK-ut 2003/13 (me ndryshime), Kaptinën e V të Urdhërësës Administrative Nr. 2006/17 ose të kontaktoni Odën e Veçantë të Gjykatës Supreme të Kosovës.



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVO - REPUBLIC OF KOSOVO

AGJENCIA KOSOVARE E PRIVATIZIMIT - KOSOVSKA AGENCIJA ZA PRIVATIZACIJU - PRIVATISATION AGENCY OF KOSOVO

Ne mbështetje të nenit 24.6 të Ligjit nr. 03/L-067 për Agjencinë Kosovare të Privatizimit, e duke iu referuar nenit 2 al.2 dhe 3, e lidhur me nenin 113.1 të Ligjit nr. 02/L-28 mbi Procedurën Administrative, dhe nenit 10.4 të Rregullores së UNMIK-ut 2003/13, dhe nenit 67.2 të UA të UNMIK-ut nr. 2008/6, Komisioni Shqyrtues pas shqyrtimit të ankesave lidhur me mospërfshirjen e emrave të tyre në Listën e Përkohshme të punëtorëve për përfitimin e një pjese nga 20% e të ardhurave nga privatizimi i NSH “Sirkos” në Prishtinë, më 28 Tetor 2010 merr këtë:

NJOFTIM MBI VENDIMIN

I. REFUZHON SI TE PABAZUARA Rama Krasniqi, Vera Muratović dhe Mustafa Qamili.

A r s y e t i m

Komisioni për shqyrtimin e ankesave duke u bazuar në provat e parashtruara me ankesat, konstaton që ankesat në vijim nuk i plotësojnë të gjitha kriteret ligjore sipas nenit 10.4 të Rregullores së UNMIK-ut nr. 2003/13.

A. Libreza e punës është mbyllur

Ankuesit Rama Krasniqi, Vera Muratović dhe Mustafa Qamili kanë parashtruar kopjet e Librezave të Punës prej të cilave shihet se librezat e punës u janë mbyllur dhe që ankuesit nuk kanë qenë të punësuar në NSH në kohën e privatizimit.

Bazuar në nenin 69 të Ligjit mbi Marrëdhëniet e Punës (“Gazeta Zyrtare e RS” nr. 29/90, 42/90, 28/91) që konsiderohet ligj i aplikueshëm në pajtim me Rregulloren e UNMIK-ut nr. 1999/24 mbi Legjislacionin në Fuqi në Kosovë, librezat e punës është dokument publik, e cila përmban shënimet mbi themelimin dhe ndërprerjen e marrëdhënies së punës.

Këshilla Juridike:

Pala e pakënaqur mund të ankohet ndaj këtij Vendimi tek Oda e Veçantë e Gjykatës Supreme të Kosovës brenda 20 (njëzet) ditësh, nga dita e fundit e shpalljes së Listës Finale, përkatësisht këtij vendimi.

Komisioni Shqyrtues i ankesave

Agjencia Kosovare e Privatizimit (AKP)